



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 30 shtator 2015**

**Numri i lëndës: 2014-11, 2014-12, 2014-13, 2014-14, 2014-15, 2014-16  
dhe 2014-17**

**D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinovic, H.S., I.R.**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 29 dhe 30 shtator 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Paul LANDERS, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **PROCEDURA**

1. Ankesat janë regjistruar përkatësisht në -
  - ankesat nr. 2014-11 deri te 2014-14 me 11 mars 2014;
  - ankesat nr. 2014-15 me 17 mars 2014; dhe
  - ankesat nr. 2014-16 dhe 2014-17 me 19 mars 2014.
2. Të gjithë ankuesit përveç njërit kanë kërkuar që identiteti i tyre mos të bëhet publik. Në bazë të natyrës së ankesave, Paneli i pranoj këto kërkesa.

3. Më 27 maj 2014, Paneli vendosi ta njoftonte rreth ankesave shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it, duke e ftuar atë të paraqes vërejtje me shkrim për ankesat. Gjithashtu Paneli vendosi të shqyrtoj meritat e aplikacionit në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tij (në pajtim me rregullën 30 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores së Punës).
4. Vërejtjet e ShM janë pranuar me datën 1 tetor 2014, e pas kësaj ato i janë komunikuar ankuesve për vërejtje shtesë.
5. Më 24 nëntor 2014, ankuesit dërguan vërejtjet e tyre shtesë, të cilat njera pas tjetrës u janë dërguar ShM-së për informim.
6. Duke marrë parasysh tonin e adresimit të ankuesve dhe përplasjen e madhe të çështjeve të ngritura në këto lëndë me njera tjetrën, Paneli përmes kësaj urdhëron bashkimin formal të këtyre shtatë lëndëve (2014-11 deri 2014-17), në pajtim me rregullën 20 të Rregullores së Punës.

## **FAKTET**

### **I. RRETHANAT E LËNDËVE**

7. Të gjithë ankuesit janë të përkatësisë etnike serbe dhe janë të përfaqësuar nga i njëjti avokat, i cili nuk është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës.

#### **Lënda 2014-11, D.W.**

8. Më 16 qershor 1999, A.W. dhe B.W., bashkëshorti dhe djali i ankuseses ishin duke vizituar shtëpinë e tyre familjare në Obiliq. Më pas, ankuesja (D.W.) ka dëgjuar të shtëna armësh që vinin nga drejtimi i shtëpisë së saj.
9. Më 20 qershor 1999, ankuesja ishte njoftuar se bashkëshorti dhe djali i saj ishin gjetur të vdekur. Ajo më vonë kuptoj se ata ishin varrosur në një varr të pashënuar. Më vonë, trupat e A.W. dhe B.W. janë gjetur dhe identifikuar nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar dhe i janë kthyer ankuseses për varrim.
10. Më 9 prill 2009, ankuesja ka parashtruar ankesë në Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut (PKDNj). Ajo pohoj se UNMIK-u ka dështuar që të hetonte si duhet vrasjen e bashkëshortit dhe djalit të saj dhe prandaj të drejtat e saj ishin shkelur. Më 6 qershor 2013, PKDNJ-ja konstatoj se kishte pasur shkelje të të drejtave të ankuseses sipas nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
11. Më 11 qershor 2013, përfaqësuesi ligjor i ankuseses ka dërguar një letër në EULEX, ku ka pyetur nëse ata kishin ndonjë të dhënë në

lidhje me A.W. dhe B.W. dhe disa persona të tjerë. Më 12 korrik 2013, shefi i Zyrës së Prokurorisë Speciale (PSRK) u përgjigj se në bazë të nenit 63 par. 1 i Kodit të Procedurës Penale (KPP), pala e dëmtuar mund të përfaqësohet vetëm nga një person i cili është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës, kështu që të dhënat nuk mund t'i ofrohen përfaqësuesit të ankuesve që nuk i përkiste Odës së Avokatëve të Kosovës.

12. Më 18 korrik 2013, ankuesja tërhoqi vëmendjen e shefit të PSRK-së tek neni 63 par. 3 i KPP-së që parashikon se pala e dëmtuar mund të përfaqësoj veten. Ajo përsëriti kërkesën e saj që informatat mbi të afërmit e saj t'i ofrohen dhe kërkoj që ato t'i dërgohen në adresën e avokatit të saj.
13. Më 9 tetor 2013, ankuesja ka marrë një letër nga shefi i PSRK-së. Ajo u informua se hetimi ishte mbyllur, pasi autori i krimit nuk ishte mundur të identifikohet ("*një aktvendim për refuzimin e kallëzimit penal të datës 20 korrik 2009 është lëshuar nga një prokuror i EULEX-it që pasi që [kur ndodhi] [...] nga kallëzimi penal nuk kishte asnjë dyshim të arsyeshëm kundër ndonjë të dyshuari të veçantë*"). Letra më tej e informoj atë se ishte lëshuar një njoftim për mbylljen e hetimeve dhe se pala e dëmtuar ka qenë e informuar për të drejtën që të procedoj me ndjekjen penale si paditës dytësor brenda tetë ditëve nga marrja e njoftimit për refuzim. Sipas letrës, kërkohej me ligj që vendimi dhe njoftimi t'i dorëzoheshin familjes së viktimës. Në të njëjtën letër, ankuesja ishte informuar se përfaqësuesi i saj do të lejohet që të hetoj të dhënat e EULEX-it rreth lëndës së saj. Ajo pohon se nuk ishte në gjendje që të organizoj një takim me EULEX-in për këtë qëllim.
14. Ankuesja tregon se zyrtarisht asnjëherë nuk ju është dorëzuar asaj vendimi për refuzimin e kallëzimit penal.

#### **Lënda 2014-12, E.V.**

15. Bashkëshorti i ankuseses, S,V., ishte sulmuar në banesën e tij në Prishtinë më 5 korrik 1999. Ai vdiq gjatë rrugës për në spital.
16. Më vonë në vitin 2000, ankuesja ishte intervistuar nga një person, i cili ajo beson se i përkiste "forcës së policisë ndërkombëtare" dhi i cili i siguroj asaj se po zhvillohej një hetim. Asaj nuk i është dhënë asnjë dokument nga zyrtari në fjalë dhe as hollësitë e kontaktit dhe që prej atëherë nuk ka dëgjuar asgjë.
17. Më 12 korrik 2013, në përgjigje të pyetjeve nga përfaqësuesi i ankuesit të datës 11 qershor 2013, shefi i PSRK-së e informoj atë se ai nuk mund t'i zbuloj asaj asnjë informacion, pasi ajo nuk ishte anëtare e Odës së Avokatëve të Kosovës.

18. Më 18 korrik 2013, E.V. ka kërkuar që të dhënat në lidhje me vdekjen e bashkëshortit të saj t'i përcillen në adresën e avokatit të saj.
19. Përkundër kërkesave të përsëritura, asnjë përgjigje tjetër nuk ishte marrë nga PSRK-ja.
20. Në parashtrimet e tij, ShM e bëri të qartë se EULEX-i nuk posedon asnjë dosje lidhur me vrasjen e bashkëshortit të ankueses. Megjithatë ata kanë qasje në Arkivin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë. Duket se dokumentet janë dorëzuar nga UNMIK-u tek autoritetet e Kosovës më 22 gusht 2008. Gjithashtu nga të dhënat duket se më 6 shkurt 2009, prokurori publik i Kosovës hodhi poshtë kallëzimin penal mbi rastin, mbi bazën se nuk ka pasur dyshim të arsyeshëm kundër asnjë të dyshuari të veçantë.

#### **Lënda 2014-13, F.U.**

21. Më 30 qershor 1999, bashkëshorti i ankueses, A.U. ishte qëlluar për vdekje në pragun e shtëpisë së të afërmit të tyre në Obiliq, gjoja nga persona me emblemë të UÇK-së.
22. KFOR-i britanik ishte në vendin e ngjarjes dhe ka përgatitur një raport rreth incidentit, duke shënuar se kishin intervistuar disa "të afërm" dhe anëtarë të familjes së ankueses.
23. Megjithatë, as raporti e as ndonjë dokument tjetër nuk i është dorëzuar familjes. Ankuesja nuk ka marrë asnjë informacion tjetër në lidhje me vdekjen dhe rrethanat e vdekjes së bashkëshortit të saj.
24. Më 1 dhjetor 1999, Policia e UNMIK-ut intervistoi katër dëshmitarë në lidhje me këtë rast. Në raportin e tyre përfundimtar, Policia sugjeroi se rasti duhet të mbyllet për shkak të mungesës së informacionit rreth të dyshuarve të mundshëm. Në raportin e UNMIK-ut lidhur me raportin e rastit të vitit 2003, statusi i lëndës është i regjistruar i mbyllur. Nuk ka asnjë informacion nëse familja e viktimës mbahej e informuar.
25. Më 12 korrik 2013, në përgjigje të pyetjeve nga përfaqësuesi i ankueses të 11 qershorit 2013, shefi i PSRK-së e informoi atë se nuk mund t'i zbulonte asnjë informacion, pasi ajo nuk ishte anëtare e Odës së Avokatëve të Kosovës.
26. Më 18 korrik 2013, ankuesja ka kërkuar që ato të dhëna që kanë të bëjnë me vdekjen e bashkëshortit të saj t'i përcillen në adresën e avokatit të saj.
27. Më 20 shtator 2013, shefi i PSRK-së informoj ankuesen se vendimi për të hedhur poshtë kallëzimin penal të datës 20 korrik 2009 ishte lëshuar nga një prokuror i EULEX-it "pasi [doli] [...] prej kallëzimit penal nuk kishte asnjë dyshim të arsyeshëm ndaj ndonjë të dyshuari të veçantë". Letra më tej e informoj atë se ishte lëshuar një njoftim për

mbylljen e hetimeve dhe se pala e dëmtuar ka qenë e informuar për të drejtën për të vazhduar me ndjekjen penale si paditës dytësor. Ajo gjithashtu u informua se përfaqësuesi i saj do të lejohet të hetoj regjistrimet e EULEX-it rreth rastit të saj. Ajo pohon se nuk ishte në gjendje të siguroj një takim me EULEX-in rreth saj.

28. Ankueses asnjëherë nuk ju është dhënë zyrtarisht vendimi i refuzimit të kallëzimit penal.

#### **Lënda 2014-14, G.T.**

29. Më 27 korrik 1999, B.T., djali i ankueses ishte vrarë në rrugë afër Vushtrrisë. KFOR-i britanik kishte dalë në vendin e ngjarjes, por ankueses nuk i ishte kërkuar të jepte informacion personal ose dëshmi dhe që atëherë nuk ka dëgjuar ndonjë gjë nga KFOR-i.
30. Më 18 korrik 2013, ankuesja ka dërguar një letër tek shefi i PSRK-së, duke e pyetur nëse ata kishin ndonjë të dhënë në lidhje me vdekjen e djalit të saj. Ajo ka kërkuar që të dhënat në lidhje me vdekjen e djalit të saj të përcillen në adresën e avokatit të saj.
31. Më 19 shtator 2013, shefi i PSRK-së u përgjigj se, pavarësisht nga ndonjë hulumtim tërësor të kryer nga Njësia e Policisë për Hetimin e krimet të luftës (NJHKL) të PSRK-së, nuk ishte gjetur asnjë e dhënë lidhur me rastin e djalit të saj.

#### **Lënda 2014-15, Zlata Veselinovic**

32. Sipas ankueses, bashkëshorti i saj, S.V. ishte qëlluar për vdekje në Prizren më 13 qershor 1999 nga ushtarët e KFOR-it gjerman. Ajo nuk e di rrethanat e sakta rreth vdekjes së tij dhe thotë se kërkesa e saj për certifikatë të vdekjes dhe informacion në lidhje me rrethanat e vdekjes së bashkëshortit të saj mbeten pa përgjigje.
33. Më 18 korrik 2013, ankuesja i dërgoj një letër shefit të PSRK-së, duke e pyetur nëse ata kishin ndonjë të dhënë në lidhje me vdekjen e bashkëshortit të saj. Ajo ka kërkuar që të dhënat në lidhje me vdekjen e bashkëshortit të saj të përcillen në adresën e avokatit të saj.
34. Më 17 shtator 2013, shefi i PSRK-së u përgjigj se PSRK-ja nuk mund të gjej ndonjë të dhënë lidhur me lëndën e ankueses. Megjithatë, ajo u informua se NJHKL kishte gjetur se S.V. paraqitej në listën e personave të zhdukur të Komisionit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.

#### **Lënda 2014-16, H.S.**

35. Vëllai i ankuesit, A.S. ishte qëlluar jashtë shtëpisë së tij në fshatin Batushë më 8 korrik 1999 dhe vdiq si pasojë e plagëve. Familja e tij

nuk ishte marrë në pyetje, e as të dhënat e tyre personale nuk ishin marrë nga KFOR-i.

36. Më 18 korrik 2013, ankuesi dërgoj një letër shefit të PSRK-së, duke pyetur nëse kishin ndonjë të dhënë në lidhje me vdekjen e vëllait të tij. Ai kërkoi që të dhënat në lidhje me vdekjen e vëllait të tij të përcillen tek ai në adresën e avokatit të tij.
37. Në një letër të datës 20 shtator 2013, shefi i PSRK-së informoj ankuesin se pavarësisht hulumtimit të plotë të kryer nga PSRK-ja dhe NJHKL-ja, nuk ishte gjetur asnjë e dhëna në lidhje me rastin e vëllait të tij A.S.

### **Lënda 2014-17, I.R.**

38. I.R., bashkëshorti i ankueses ishte qëlluar për vdekje në periferi të Bërnicsës së Ulët më 11 mars 2000.
39. Më 29 mars 2000, ankuesja ka marrë një memorandum nga një hetues i njësisë së hetimeve rajonale të UNMIK-ut. Ajo u informua se rasti i vdekjes së bashkëshortit të saj ishte nën hetime dhe se asnjë i dyshuar nuk ishin identifikuar në atë fazë.
40. Më 18 korrik 2013, ankuesja i dërgoi një letër shefit të PSRK-së, duke pyetur nëse ata kishin ndonjë të dhënë në lidhje me vdekjen e bashkëshortit të saj. Ajo ka kërkuar që të dhënat në lidhje me vdekjen e bashkëshortit të saj t'i përcillen asaj në adresën e avokatit të saj.
41. Më 19 shtator 2013, shefi i PSRK-së ka informuar ankuesin se pavarësisht nga hulumtimi i plotë i kryer nga PSRK-ja dhe NJHKL-ja, nuk ishin gjetur të dhëna në lidhje me rastin e bashkëshortit të saj.
42. Më 31 tetor 2013, përfaqësuesi ligjor i ankueses i ka dërguar shefit të PSRK-së memorandumimin e UNMIK-it të datës 29 mars 2000 (shih par. 39 më lartë) dhe i ka kërkuar atij që të rishikoj pozicionin e tij sa i përket informacionit që ai përmban. Ankuesi nuk ka marrë asnjë përgjigje rreth këtij hetimi.

## **II. ANKESAT**

43. Ankuesit i referohen dy të drejtave të veçanta themelore që reflektohen në dispozitat e mëposhtme: Neni 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) nën pjesën e tij procedurale, e cila garanton të drejtën themelore të personit për jetë dhe parasheh obligimin për të hetuar rastet e vdekjeve të dyshimta; Neni 3 i Konventës, i cili garanton të drejtën e personit për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

## II. LIGJI PËRKATËS NË FUQI

### Veprimi i Përbashkët

#### **VEPRIMI I PËRBASHKËT I KËSHILLIT 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 mbi Misionin për Sundimin e Ligjit Evropian në Kosovë, EULEX-i KOSOVË**

##### **Neni 2 Deklarata e Misionit**

EULEX KOSOVË do t'i ndihmoj institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt stabilitetit dhe besueshmërisë në zhvillimet e mëtutjeshme dhe forcimin e sistemit të pavarur shumetnik të drejtësisë, të policisë, të doganës duke siguruar që këto institucione nuk do të ndikohen politikisht dhe do t'ju përmbahen standardeve të pranura ndërkombëtare dhe praktikave më të mira evropiane.

##### **Neni 3 Detyrat**

Me qëllim të përmbushjes së Deklaratës së Misionit të përcaktuar në nenin 2, EULEX-i KOSOVË do të:

(...)

(h) merr përgjegjësi të tjera, qoftë ndarazi apo në bashkëpunim me autoritetet kompetente të Kosovës, për të siguruar zbatimin dhe promovimin e sundimit të ligjit, të rendit publik dhe sigurisë, në konsultim me agjencitë përkatëse të Këshillit; dhe

### Ligji mbi kompetencat

#### **Ligji Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në KOSOVË (në fuqi deri më 30 maj 2014)**

##### **Neni 3 Juridiksioni dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it në procedurë penale**

(...)

3.3. Para fillimit të fazave përkatëse të procedurës dhe pas kërkesës së prokurorit të EULEX-it të caktuar në lëndë apo që punon në ekipin e përzier të identifikuar në nenet 9 dhe 10 të këtij ligji apo pas kërkesës së cilësdo palë në procedurë, apo pas kërkesës me shkrim të kryetarit të gjykatës kompetente apo të seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës kur nuk zbatohen dispozitat lidhur me përjashtimin e një gjyqtari apo një gjyqtari porotë të paraparë sipas KPPPK-së (neni 40-44 i KPPPK-së), kryetari i asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të ketë kompetencë, çdoherë kur konsiderohet e nevojshme që të sigurohet administrimi i duhur i drejtësisë, që t'i caktoj gjyqtarët e EULEX-it në fazën përkatëse të një procedure penale në përputhje me modalitetet për përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të përcaktuara nga asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it dhe në pajtim me këtë ligj, për krimet e poshtëshënuara, atëherë kur hetimi a ndjekja penale nuk kryhet nga PSRK-ja:

(...)

h) shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës (neni 158, KPPK)

**Neni 12 Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në rast të mosgatishmërisë apo paaftësisë të prokurorëve publik të Kosovës**

12.1 Në çdo fazë të çdo procedure penale, nëse një prokuror publik i Kosovës nuk është i gatshëm apo është i paaftë që të ushtroj detyrat e tij dhe kjo mosgatishmëri apo paaftësi mund të rrezikoj hetimin apo ndjekjen e duhur të një veprë penale, apo kurdoherë që ekziston dyshimi i bazuar se bëhen përpjekje për të ndikuar në hetimin apo ndjekjen e një veprë penale, kryeprokurori i EULEX-it ka kompetencë që të kërkoj nga kryeprokurori i zyrës kompetente që atë lëndë t'ia caktoj: a) një prokurori tjetër publik të Kosovës që punon në të njëjtën zyre prokuroriale, b) apo cilitdo prokuror të EULEX-it që do të marrë përgjegjësinë për hetimin apo ndjekjen penale përkatëse.

12.2 Nëse kryeprokurori i zyrës kompetente kundërshton kërkesën e kryeprokurorit të EULEX-it, kryeprokurori i EULEX-it do ta njoftoj kryeprokurorin publik të Kosovës dhe së bashku do të marrin një vendim të përbashkët i cili do të respektohet nga kryeprokurori i zyrës kompetente.

12.3 Në rrethana urgjente ose kur vonesa mund të ndikoj në kryerjen apo rezultatin e hetimit, ndjekjes penale apo zhvillimit të drejtë të procedurës, kryeprokurori i EULEX-it do të ketë të drejtë që të ndërmerr çdo veprimi urgjent procedural apo të caktoj cilindo prokuror të EULEX-it apo prokuror publik të Kosovës për një qëllim të tillë.

***Ligji Nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës (në fuqi prej 31 majit 2014)***

**Neni 3 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë**

.....

3. Pas nenit 1 të ligjit bazik, shtohet një nen i ri 1.A me tekstin si në vijim:

Neni 1.A Rastet në proces

Për qëllime të këtij ligji, rast në proces nënkupton:

1. Rastet për të cilat vendimi për fillimin e hetimeve është dhënë para datës 15 prill 2014 nga prokurorët e EULEX-it në pajtim me ligjin;
2. Rastet të cilat u janë caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill 2014.

.....

9. Neni 7 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 7 Autoriteti dhe kompetencat e përgjithshme të prokurorëve të EULEX-it

7.1. Prokurorët e EULEX-it do të kenë autoritet dhe përgjegjësi t'i kryejnë funksionet e tyre, përfshirë autoritetin për kryerjen e hetimeve penale ashtu si përcaktohet në nenin 2.1 të këtij ligji, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj.



7.2. Prokurorët e EULEX-it do të jenë kompetentë për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që janë në kompetencë të PSRK-së në pajtim me ligjin mbi PSRK-në.

7.3. Prokurorët e EULEX-it janë të integruar në sistemin prokurorial të Kosovës dhe do të ushtrijnë funksionet e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

7.4. Rastet e udhëhequra nga prokurorët e EULEX-it të përcaktuara në nenin 2.1 të këtij ligji do të vazhdojnë të menaxhohen në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi juridiksionin, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (2008) dhe të Ligjit për PSRK-në (2008).

7.5. EULEX-i KOSOVË do të caktoj prokurorë që të ndihmojnë lidhur me zbatimin, sipas marrëveshjes, të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të ndërmjetësuar nga BE-ja.

7.6. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, prokurorët e EULEX-it do t'i bashkërendojnë aktivitetet e tyre me kryeprokurorin përgjegjës për zyrën të cilën ata janë të vendosur.

....

10. Pas nenit 7 të ligjit, shtohen dy nene të reja 7.A dhe 7.B me tekstin si në vijim:

Neni 7.A            Autoriteti i prokurorëve të EULEX-it në rrethana të jashtëzakonshme

Në rrethana të jashtëzakonshme, një rast mund t'i caktohet në prokurori të EULEX-it nga një vendim i përbashkët i kryeprokurorit të shtetit dhe autoritetit kompetent të EULEX-it KOSOVË.

#### ***Ligji Nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës***

Neni 5                    Kompetenca e veçantë e PSRK-së

5.1 PSRK-ja do të ketë kompetencë të veçantë që të hetoj dhe ndjek penalisht krimet, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krim si vijon:

.....

e) krimet kundër njerëzimit (neni 117, KPPK);

f) krimet e luftës në kundërshtim të rëndë me konventat e Gjenevës (neni 118, KPPK), krimet e luftës si shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar (neni 119, KPPK), krimet e luftës për shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët me konventat e Gjenevës (neni 120, KPPK), krimet e luftës të cilat paraqesin shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë në karakterit ndërkombëtar (neni 121, KPPK);

...

n) krimi i organizuar (neni 274, KPPK), kërcënimi gjatë procedurave penale për krim të organizuar (neni 310, KPPK);

.....

Neni 9                    Kompetenca plotësuese e PSRK-së

9.1 PSRK-ja do të ketë kompetencë plotësuese, sipas modaliteteve të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krim si në vijon:

.....  
b) nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar a etnik (neni 115, KPPK);

.....  
h) vrasja (neni 146, KPPK), vrasja e rëndë (neni 147, KPPK);

i) marrja e pengjeve (neni 143, KPPK);

j) shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës (neni 158, KPPK);

k) rrëmbimi i personit (neni 159, KPPK);

.....

## LIGJI

44. Ankuesit pohojnë se EULEX-i ka shkelur të drejtat e tyre të mbrojtura me nenet 2 dhe 3 të Konventës. Në këto dispozita, për aq sa janë relevante, thuhet si në vijim:

### **Neni 2 E drejta për jetën**

1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.

...

### **Ndalimi i torturës**

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

45. Përveç këtyre dispozitave, Paneli vendosi *proprio motu* që gjithashtu ta komunikoj dhe shqyrtoj lëndën sipas neneve 8 dhe 13 të Konventës, e cila thotë si në vijim:

### **NENI 8 E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare**

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyj në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

### **Neni 13 E drejta për zgjidhje efektive**

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

## **Parashtrimet nga palët**

### **Shefi i Misionit (“ShM”)**

46. ShM ka pohuar se detyra kryesore e EULEX-it është të mbështes autoritetet vendore duke i mbajtur disa funksione të kufizuara ekzekutive. Prandaj ai pohoj se përgjegjësia e Misionit për të mbrojtur të drejtat e njeriut nuk mund të barazohet me atë të një shteti.
47. Më tej shefi i Misionit komentoj rreth kompetencës së prokurorëve të EULEX-it për t'u marrë me rastet. Ai pohoj se rastet 2014-12, 2014-13, 2014-14 dhe 2014-16 kishin të bëjnë me vrasjet të cilat nuk mund të konsiderohen krime lufte (dhe si të tillë bien nën kompetencë të veçantë të prokurorëve të EULEX-it), pasi ato kanë ndodhur pas 20 qershorit 1999, data kur Ushtria Jugosllave ishte certifikuar që zyrtarisht ishte jashtë territorit të Kosovës. Prandaj ata do të hetohen dhe të ndiqen penalisht nën kapitujt e *rregullta* të Kodit Penal (p.sh. si vrasje). Prandaj, para ndryshimeve legjislative të prillit 2014 në Ligjin Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë (Ligji mbi kompetencat) të EULEX-it, prokurorët e EULEX do ta kishte ndarë apo do të kishin pasur kompetencë plotësuese mbi raste të tilla.
48. Më tej ai sqaroj se nga 9 dhjetori 2008, prokurorët e EULEX-it kanë marrë nga prokurorët e UNMIK-ut vetëm dosjet “aktive” hetimore, të trajtuara më parë nga prokurorët apo policia e tyre, pra dosjet në lidhje me rastet në proces në datën e dorëzimit. Rastet të cilat ishin ndërprerë, hedhur poshtë apo ndryshe të mbyllura nga UNMIK-u ishin arkivuar në zyrat e Prokurorisë vendore të Kosovës. Prandaj sipas ShM-së do të ishte e pasaktë të supozohej se EULEX-i i ka marrë të gjitha dosjet e policisë dhe prokurorisë. Për më tepër, EULEX-i nuk do të kishte qenë në gjendje t'i gjente të gjitha dosjet e policisë dhe të prokurorisë të trajtuara nga autoritetet e Kosovës, e lëre më ato të cilat KFOR-i ishte përgjegjës i parë.

### *Vërejtjet në rastet 2014-12, 2014-14, 2014-15, 2014-16 dhe 2014-17*

49. Për sa i përket rasteve nr. 2014-12, 2014-14, 2014-15, 2014-16 dhe 2014-17, EULEX-i ka kontaktuar autoritetet vendore për të gjetur nëse kishin dosje në lidhje me këto incidente. Vetëm dosja në lidhje me ankesën 2014-12 u gjet në Arkivin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë (shih par. 20 më lartë).
50. Mbi këtë bazë, ShM argumentoj se rastet që i nënshtrohen ankesave asnjëherë nuk ishin në posedim të EULEX-it dhe për këtë arsye EULEX-i nuk ka ushtruar ndonjë lloj kompetence ekzekutive mbi to. Prandaj, këto ankesa duhet të refuzohen në përputhje me rregullat 25 par. 1 të rregullores së punës së Panelit, pasi bien jashtë kompetencës materiale dhe personale të Panelit.

*Vërejtjet në rastet 2014-11 dhe 2014-13*

51. Për sa i përket rasteve 2014-11 dhe 2014-13, ShM ka deklaruar se prokurorët e EULEX-it u njoftuan rreth tyre në vitin 2009 derisa i shqyrtonin dosjet e dorëzuara nga UNMIK-u. Prokurorët e EULEX-it të caktuar për shqyrtimin e këtyre rasteve konsideruan se të gjitha hapat hetimorë përkatës ishin marrë nga hetuesit e UNMIK-ut dhe se të gjitha informatat ishin shterur. Prandaj, rastet janë hedhur poshtë për shkak të mungesës së ndonjë strategjie të arsyeshme hetimore apo ndonjë treguesi rreth të dyshuarve të mundshëm.
52. ShM pranoj se veprimet e prokurorëve të EULEX-it përpara fillimit të procedurave gjyqësore në parim hyjnë në kuadër të juridiksionit të Panelit. Megjithatë, këto raste kanë qenë joaktive për vite dhe praktikisht të mbyllura nga hetuesit e UNMIK-ut për shkak të mungesës së ndonjë të dyshuari të mundshëm para se të transferoheshin në EULEX. Prokurori i EULEX-it thjesht ka dhënë një vendim zyrtar për mbylljen e rasteve pasi u konsiderua se nuk kishin mbetur hapa të tjerë hetimor. Prandaj sipas ShM nuk ka asnjë lidhje të vërtetë ndërmjet incidenteve fillestare të vrasjeve dhe veprimeve të ndërmarra nga prokurorët e EULEX-it në vitin 2009.
53. Për më tepër, ShM pohoj se Paneli shqyrton vetëm ankesat për shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur pas datës 9 dhjetor 2009. Vdekja e të afërmeve të ankuesve ka ndodhur në vitin 1999. Sipas ShM, mungonte "lidhja e vërtetë" në mes të zhdukjes dhe 9 dhjetorit 2009 si datë e fillimit të juridiksionit, kështu që Paneli nuk ishte kompetent për të shqyrtuar këtë çështje. Një pjesë e konsiderueshme e hapave procedurale të nevojshme ishin ose duhej të ishin kryer nga UNMIK-u para kësaj date. Hetimi fillestar dhe regjistrimi i ngjarjeve nuk ishte pa të meta, mirëpo EULEX-i nuk duhet të konsiderohen përgjegjës për dështimin për të hetuar rastet që kishin qenë praktikisht joaktive për vite me radhë.
54. ShM gjithashtu pohoj se rastet ishin paraqitur jashtë afatit kohor gjashtë mujor, të përcaktuar në rregulloren e punës së Panelit. Sipas ShM, ankuesit mund të kishin kontaktuar EULEX-in më herët se viti 2013 dhe t'i parashtronin ankesat e tyre pranë Panelit para vitit 2014. Po ashtu komunikimi i fundit ndërmjet PSRK-së dhe ankuesve ka ndodhur në shtator të vitit 2013 dhe ankesat në Panelit janë paraqitur në mars të vitit 2014, e që është afërsisht mbi gjashtë muaj më vonë.
55. Bazuar në faktin se ai konsideroj se çfarëdo dështimi hetimor në këto raste nuk i atribuohet EULEX-it, ShM nuk pranoi të merr ndonjë qëndrim sa i përket meritës së ankesave sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës.
56. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të neneve 8 dhe 13 të Konventës, ShM ka argumentuar se refuzimi i kallëzimeve penale nuk përbënte ndonjë vendim përfundimtar, që do të thotë se rastet mund të rihapeshin nëse paraqitej informacion apo dëshmi e re. Ankuesit

kanë të drejtë të kërkojnë rishikimin apo rihapjen e hetimeve, ose rasti mund të rihapet sipas detyrës zyrtare. Pra mjeti efektiv i ankimit është teorikisht në dispozicion të tyre sipas ligjit të Kosovës dhe nuk ngritët asnjë çështje sipas nenit 13.

57. Sipas ShM, nuk ka pasur asnjë ndërhyrje në të drejtën e ankuesve sipas nenit 8 që mund t'i atribuoheshin Misionit. Ankuesit nuk ishin të informuar zyrtarisht për refuzimin e kallëzimeve penale në vitin 2009, sepse adresat dhe vendndodhja e tyre nuk ishin të njohura nga EULEX-i. Kjo u korigjua në vitin 2013, kur informacioni u bë i njohur. Ankuesit kanë të drejtë të kenë qasje në dosjen e rastit, por ata duhet të bëjnë atë personalisht ose ta autorizojnë një përfaqësues, i cili është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës. Një qasje e tillë ishte dhënë nga PSRK-ja në vitin 2013, por ShM sugjeron se ankuesit nuk e shfrytëzuan këtë.

### **Ankuesit**

58. Në përgjigjen e tyre ndaj vërejtjeve të ShM-së, ankuesit përsëritën se EULEX-i në mënyrë efektive ka vazhduar të shkelë të drejtat e tyre në nenin 22, me veprimin e tij i ka vënë ankuesit në trajtim çnjerëzor dhe poshtëruar, në kundërshtim me të drejtat e tyre të mbrojtura me nenin 3 të Konventës.

59. Ankuesit pretenduan se kishte prova bindëse se krimet kundër të afërmeve të tyre janë bërë në mënyrë të organizuar dhe ishin urdhëruar nga një nivel i lartë i udhëheqjes së UÇK-së. Natyra e gjerë ose sistematike e këtyre krimeve në periudhën e pas konfliktit që përfundoj në qershor të vitit 1999 sipas këndvështrimit të tyre e arsyeton ndjekjen penale të krime kundër njerëzimit.

60. Ankuesit nuk u pajtuan me vërejtjet e ShM-së lidhur me afatin për hetimin e krimeve si krime lufte që sipas ShM-së duhej të ishte deri me 20 qershor 1999. Sipas mendimit të tyre, emërtimi se krimet e kryera kundër të afërmeve të ankuesve si vepra të hetohen dhe të ndiqen penalisht nën kapitujt e rregullta të Kodit Penal dhe jashtë kompetencës ekskluzive të EULEX-it do të përbënte një dështim nga ana e EULEX-it për të përmbushur mandatin e vet ekzekutiv.

61. Për sa i përket ankesave nr. 2014-11, 2014-12 dhe 2014-13, ankuesit pohuan se hetimet fillestare kishin gabime dhe për këtë arsye rastet duhet të ri-hapen dhe të kryhet një hetim efektiv nga hetuesit ndërkombëtarë kompetent dhe të paanshme.

62. Në lidhje me rastet e mësipërme, ankuesit sqaruan se familjet e viktimave nuk kishte qenë të informuar për rezultatet e hetimeve fillestare. Ata hodhën poshtë shpjegimin e ShM-së se për shkak se ata jetonin në Serbi nuk ishte e mundur dorëzimi i aktvendimeve për shkak të "situatës politike". Ata pohuan se përfaqësuesi i tyre që

gjendet në Londër ishte lehtësisht në gjendje të komunikonte me klientët e saj. Nëse do të tentonte të vepronte ashtu, EULEX-i do të kishte qenë në gjendje të komunikoj me ankuesit pa vështirësi apo pengesë.

63. Sa i përket rasteve të tjera, ankuesit pohuan se ato pasqyrojnë dështimin e përgjithshme të EULEX-it për të hetuar në mënyrë adekuate rastet e tilla. Kur EULEX-i është informuar për këto raste nga ankuesit në qershor të vitit 2013, mundej dhe duhej që së paku të kishte kontaktonte autoritetet britanike apo gjermane apo në rastin nr. 2014-17, UNMIK-un rreth të dhënave të tyre.
64. Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë *ratione temporis*, ankuesit pohuan se fakti që EULEX-i është themeluar në vitin 2008 nuk e mohon obligimin e tij që të përmbush mandatin e tij dhe që të siguroj se krimet e luftës dhe krimet ndër-etnike të hetohen në mënyrë efektive. Në kontekstin e Kosovës detyra dhe dështimi i vazhdueshëm për të hetuar raste të tilla përbën shkelje të vazhdueshme të nenit 2 dhe 3. Më tej, pas konfliktit, ankuesit dhe familjet e tyre u bënë persona të zhvendosur në Serbi që jetonin në kushte të mjerueshme, duke u përballë me pikëllimin e humbjes së të dashurit e tyre. Të pritët prej tyre që t'i ndiqnin tre organizata ndërkombëtare në këto rrethana do t'i vendoste një barrë shumë të vështirë për ta. Ankuesit përsëritën se jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kërkon që autoritetet të kryejnë një hetim nga vetë ata, që familja të informohet për hapat që po ndërmerren dhe se hetimi të hapet për shqyrtim publik.
65. Në përgjigje të vërejtjeve të ShM-së rreth zbatimit të rregullës gjashtëmujore nga ana e ankuesve, ata theksuan se të gjitha ankesat ishin paraqitur brenda 6 muajve nga data kur ata morën informacionin, ku bëri që ata të kuptonin se EULEX-i kishte shkelur të drejtat e tyre të njeriut.
66. Për sa i përket meritave të lëndës, ankuesit pohuan se shkelja e vazhdueshme e të drejtave të tyre sipas neneve 2 dhe 3 i atribuohet EULEX-it. Ata theksojnë faktin se EULEX-i nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të hetuar krimet e kryera dhe është mbështetur në punën hetimore të UNMIK-ut, i cili ishte gjetur se kishte shkelur nenin 2 të të drejtave në të gjitha lëndët, përveç njëres prej lëndëve që ishin parashtruar në PKDNj-së. Dështimi i UNMIK-ut dhe EULEX-it për bartjen efektive të të gjitha dosjeve të UNMIK-it në EULEX nuk mund të mbahet si arsyetim apo shfajësim për shkeljen e vazhdueshme të të drejtave të ankuesve.
67. Ankuesit konkluduan se rastet e tyre duhet të shpallen të pranueshme dhe kërkuan leje për të paraqitur një përgjigje të ndryshuar pas shqyrtimit të dosjeve.

## Vlerësimi i Panelit

*Mandati i Panelit (Rregulla 25 par. 1 i Rregullores së Punës) dhe kufizimet e pandara të vëna mbi Misionin lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut*

68. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet demokratike ligjore.
69. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do t'i pranoj ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
70. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtoj vetëm ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
71. Paneli tashmë ka vendosur se veprimet e prokurorëve dhe të policisë së EULEX-it janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe për këtë arsye kjo hyn në kuadër të mandatit të Panelit (shih për shembull *K deri te T kundër EULEX-it*, lëndët nr. 2013-05 në 2013-14, 21 prill 2015 § 43; *Krlc kundër EULEX-it*, nr. 2012-21 26 gusht 2014, § 23; *Y kundër EULEX-it*, nr. 2011-28, 15 nëntor 2012, § 35).
72. Paneli tanimë ka pasur rastin të theksohej se misioni i EULEX-it nuk është shtet dhe se aftësia e tij për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohen në të gjitha aspektet përkatëse të asaj që mund të pritët prej një shteti (shih vendimin e Panelit në *A, B, C, D kundër EULEX-it*, nr. 2012-09 në 2012-12, 20 qershor 2013, § 50; *K deri te T kundër EULEX-it*, cituar më lartë, § 53; krahasoni edhe vendimin PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, §35).
73. Paneli gjithashtu vëren vështirësitë që domosdoshmërisht përfshihen në hetimin e krimeve të rënda në një shoqëri të pasluftës, siç është Kosova (shih *Palic kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, nr. 4704/04, 15 shkurt 2011 § 70; Vendimi i PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, par. 44 dhe 62 e tutje). Megjithatë këto vështirësi nuk duhet të shërbejë për t'i kamufluar apo shpjeguar dështimet që në asnjë mënyrë kuptimplote nuk lidhen me to. Prandaj në secilin rast Paneli do të vlerësoj nëse ndonjë hap i veçantë hetimor që normalisht ishte i hapur do të kishte qenë i pamundur apo jopraktik për arsyet që lidhen me rrethanat e pas konfliktit.

74. Prandaj pritet që janë vënë mbi aftësinë e EULEX-it për të hetuar dhe zgjidhur çështje komplekse kriminale duhet të jetë realiste dhe mos të vënë mbi misionin një barrë të disproporcionale që mandati dhe burimet e saj nuk janë në gjendje të përmbushin (shih vendimin e PKDNJ në lëndët nr. 248/09, 250 / 09 dhe 251/09, cituar më lartë, §§ 70-71). Prandaj në çdo rast Paneli pritet të shqyrtoj nëse ka pasur pengesa konkrete dhe reale që mund ta kenë dëmtuar mundësinë që EULEX-i të kryen një hetim të shpejtë dhe efektiv rreth një lënde. Një vlerësim i tillë nuk ka për qëllim që të justifikoj të metat operacionale që nuk lidhen me sfida konkrete dhe të dukshme.
75. Në çdo rast, në veçanti në rastet me këtë seriozitet, autoritetet hetimore priten të veprojnë shpejt për aq sa është e arsyeshme dhe të përdorin burime në përputhje me nevojën dhe mundësinë për zgjidhjen e lëndës. Përderisa autoritetet hetuese nuk mund të priten t'i zgjidhin të gjitha lëndët e sjella para tyre, prej tyre pritet që në çdo rast të veprojnë me zell, shpejtësi dhe efikasitet të tillë që e pasqyrojnë seriozitetin e lëndës që është duke u hetuar (*shih Varnava dhe të Tjerët kundër Turqisë* [GC], § 191, KEDNJ 2009; *Palic kundër Bosnjë dhe Hercegovinës*, cituar më lartë, § 63). Një angazhim dhe përkushtim i rreptë me këto standarde është veçanërisht i rëndësishme për një mision të sundimit të ligjit si EULEX që ka për qëllim të shërbejë si shembull i përkushtimit të shoqërisë për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe për ndërtimin e një ndjenje të fortë të përgjegjësisë ndaj shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Çfarëdo standardi më pak se ky do të rrezikonte krijimin e një ndjenje pajtimi me mosndëshkimin dhe mospërfilljen e kërkesës legjitime të viktimave për drejtësi dhe llogaridhënie (shih vendimin e PKDNJ-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, § 80).
76. Në kontekstin e tanishëm, nuk ka asnjë dyshim se hetimi i fatit të të vrarëve dhe të zhdukurve, pa dallim feje apo etnie, duhet të jetë dhe duhet të mbetet prioritet operacional për EULEX-in si mision i sundimit të ligjit për të cilën ai duhet të pajiset me burime të mjaftueshme.

*Lidhja e mjaftueshme kohore me sjelljen bazë - Kompetenca e Panelit ratione temporis*

77. Siç u përmend më lartë, ShM argumenton se Panelit i mungon juridiksioni *ratione temporis* mbi lëndët nr. 2014-11 dhe 2014-13, pasi nuk ka asnjë lidhje të mjaftueshme kohore midis sjelljes bazë dhe parashtrimit të ankesës në Panel (shih par. 52 më lartë). Për arsyet e përshkruara më poshtë, Paneli refuzon këtë pjesë të argumentimit.
78. Së pari, ankesat nuk kanë të bëjnë me vrasjet aktuale të të afërmeve të ankuesve, por për atë që ata e konsiderojnë të jetë dështim i vazhdueshëm që të hetohen plotësisht dhe në mënyrë efektive rastet e tyre. Në këtë kuptim, ankesat kanë të bëjnë me shkeljet e pohuara të pjesëve procedurale, kundrejt pjesëve substanciale të neneve 2 dhe 3 (përveç shkelje të neneve 8 dhe 13 të Konventës).



79. Së dyti, Paneli konstaton se ankuesit asnjëherë nuk kanë hequr dorë nga ndjekja e pretendimit të tyre. Për këtë qëllim ata kanë kërkuar nga autoritete të ndryshme (vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë UNMIK-un, qeverinë britanike, degë të ndryshme të EULEX-it), të cilat ata mendonin se mund t'ju ndihmojnë, që të marrin informacionin e duhur. Fakti që një sërë autoritetesh pasuan njëri-tjetrin në hetimin e rasteve të tyre, jo gjithmonë me qartësi të madhe për sa i përket përgjegjësive të tyre përkatëse sipas situatave të njëpasnjëshme komplekse ligjore të autoriteteve ndërkombëtare dhe autoriteteve të reja të Kosovës me të drejtë nuk mund që t'i imponohet ankuesve.
80. Së treti, Paneli thekson se edhe pse në rastet në fjalë nuk ka ndonjë hetim në proces e sipër në këtë moment dhe se kompetencat e prokurorëve të EULEX-it për të hetuar mund të jenë të kufizuara në bazë të ligjit të ndryshuar për Kompetencat, EULEX-i ka qenë i përfshirë në hetimet e kësaj çështjeje (shih par. 13 dhe 27 më lartë). Një sjellje e tillë në mënyrë të padiskutueshme hyn në kuadër të kompetencave *temporis ratione* të Panelit. Me qëllim të garantimit të mbrojtjes efektive të të drejtave të ankuesve, kjo periudhë nuk mund që në mënyrë kuptimplote të ndahet nga hetimi që është kryer deri në këtë fazë (krahaso *Thaqi kundër EULEX-it*, nr. 2010-02, 14 shtator 2011, § 85-89). Prandaj Misioni duhej që të siguronte, përdorur ishte kompetent mbi këto raste, që të përdornin me zell dhe me kohë burimet e tyre për të zhvilluar hetimin e tyre.
81. Bazuar në atë që u tha më sipër, Paneli është i mendimit se ka juridiksion *ratione temporis* mbi rastet, pasi ekziston një "lidhje e vërtetë" midis shkeljes së pretenduar të të drejtave të ankuesve dhe juridiksionit të Panelit (lënda *Thaqi kundër rast EULEX-it*, cituar më lartë).

#### *Kompetenca ratione materiae e Panelit*

82. ShM kundërshton pranueshmërinë e lëndëve nr. 2014-12, 2014-14, 2014-15, 2014-16 dhe 2014-17 bazuar në pikëpamjen se ata nuk ishin në kompetencë të prokurorëve të EULEX-it, kështu që asnjë veprim apo dështim që ka kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesve nuk mund t'i ngarkohet Misionit. Paneli nuk pajtohet me këtë analizë.
83. Si çështje paraprake, Paneli thekson se këto ankesa nuk kanë të bëjnë me veprimet ose mosveprimet e KFOR-it apo UNMIK-ut, por me atë që thuhet se i atribuohen Misionit. Kompetenca e Panelit është e kufizuar në ato veprime dhe lëshime të pretenduara, të cilat i atribuohen Misionit gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
84. Për sa i përket kompetencave *ratione materiae* të tij, Paneli së pari vëren parashtresat e ShM-së, të cilat sigurojnë se prokurorët e EULEX-it kanë kompetenca të përgjithshme mbi llojin e rasteve në

fjalë të ankesave (shih par. 47 më lartë). Paneli gjithashtu vëren pranimin nga ana e shefit të Misionit të rëndësisë së të drejtave të garantuara sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës, të cilat dyshohet se janë shkelur në këtë rast (“EULEX-i është i angazhuar që të siguroj se të gjitha aktivitetet e tij respektojnë standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut” dhe pranojnë “karakterin themelor dhe rëndësinë e të drejtave të mbrojtura sipas neneve 2 dhe 3 të KEDNj-së, si dhe obligimet procedurale që lidhen me këto të drejta”).

85. Në lidhje me kompetencën e Misionit për të hetuar këto raste të veçanta, Paneli vëren si në vijim. Neni 5 i Ligjit mbi Kompetencat parasheh kompetencën ekskluzive të prokurorëve të EULEX-it për të hetuar dhe ndjekur penalisht, ndër të tjera, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit. Përderisa nuk mund të diskutohet nëse krimet e kryera si pasojë e një konflikti të armatosur mund të kualifikohet si krime lufte, nuk ka asnjë polemikë se ato ligjërisht mund të përbëjnë krim kundër njerëzimit. Tashmë mbi këtë bazë këto krime do të kishte hyrë në kuadër të kompetencave të prokurorëve të EULEX-it në bazë të nenit 5 të Ligjit mbi kompetencat.
86. Për më tepër, neni 8 i Ligjit mbi Kompetencat ka të bëjë me rrëmbim, pengmarrje dhe vrasje dhe neni 11-12 i Ligjit mbi Kompetencat që ka të bëjnë me krimet e motivuara nga urrejtja gjithashtu do të kishin ofruar një bazë të vlefshme ligjore për prokurorët e EULEX-it për të hetuar këtë rast. Kjo në fakt është pranuar nga ShM-ja ku vuri në dukje se prokurorët e EULEX-it do të kishin pasur kompetenca të përbashkëta mbi rastet që nuk mund të konsideroheshin krime lufte, por që do të hynin në kapitujt e rregullta të Kodit Penal.
87. Sipas mendimit të Panelit, dispozitat e cituara më sipër në mënyrë të qartë kanë ofruar bazë të mjaftueshme ligjore që i jep prokurorëve të EULEX-it kompetenca (ekskluzive ose të përbashkët) për të hetuar rastet.
88. *Obligimi* i Misionit për të hetuar këto lëndë lind jo prej këtyre dispozitave, por prej neneve 2-3 të Konventës Evropiane, të cilat i japin mandat atyre që obligohen nga Konventa për të hetuar shkeljet e dyshuara të këtyre të drejtave (*McCann dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lartë, §161, *Assenov dhe të Tjerët kundër Bullgarisë*, aktgjykimi i datës 28 tetor 1998, Raportet e Aktgjykimeve dhe Vendimeve 1998-VIII, § 102).
89. ShM gjithashtu pohoj se prokurorët e EULEX-it asnjëherë nuk patën zyrtarisht kompetencë për të hetuar këto lëndë, pasi dosja e lëndës zyrtarisht nuk ju është dhënë atyre. Paneli nuk mund t'i pranoj këto parashtrime, të paktën për dy arsye. E para është se kjo është përgjegjësi e Misionit për të siguruar se e organizon veten në një mënyrë të tillë që të garantoj mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Tashmë Paneli ka theksuar në rastet e mëhershme se nga një Mision siç është EULEX-i pritet që t'i organizoj të dhënat e veta dhe t'i bart ato në atë mënyrë që do të

ishte në gjendje të garantoj në të gjitha rrethanat mbrojtjen efektive të të drejtave të të prekurve në ato dosje (Becic kundër EULEX-it, 2013-03, 12 nëntor 2014, §§ 58-60). Arsyeja e dytë është se mbrojtja efektive e këtyre të drejtave nuk mund të varet nga marrëveshja e veçantë midis UNMIK-ut dhe EULEX-it në lidhje me transferimin e dosjes së lëndës. Misioni u informua siç duhej nga ankuesit lidhur me ekzistencën e lëndëve të tilla. Nga pikëpamja e ligjit për të drejtat e njeriut, përgjegjësia e Misionit për të hetuar këto lëndë nuk ishte dhe nuk ka mundur të varej nga parashtrimi formal i një dosje “aktive” të lëndës nga UNMIK-u. Kjo ishte përgjegjësi e vetë Misionit që të shqyrtoj dhe hetoj në mënyrë efektive këto lëndë, atëherë kur ato u sollën në vëmendjen e tyre.

90. Së fundi, ShM pohon se legjislacioni i ri që ka hyrë në fuqi me 7 maj 2014 ka “ulur ndjeshëm mundësinë që prokurorët dhe gjykatësit e EULEX-it të ushtrojnë funksione ekzekutive në lëndë të reja” (Përgjigje, fq. 6, duke iu referuar Ligjit omnibus që ka ndryshuar Ligjin mbi Kompetencat). Megjithatë Paneli vëren se neni 7(A) parasheh “Autoritetin e prokurorëve të EULEX-it në rrethana të jashtëzakonshme”: “Në rrethana të jashtëzakonshme një lëndë do t’i caktohet një prokurori të EULEX-it me një vendim të përbashkët nga kryeprokurori i shtetit dhe autoriteti kompetent i EULEX-it KOSOVË. “ShM nuk ka arritur të shpjegoj pse kjo dispozitë nuk ofron ndonjë bazë të duhur ligjore mbi të cilën prokurorët e EULEX-it duhet të veprojnë, në mënyrë të veçantë në një rast të tillë si kjo lëndë, ku as UNMIK-u e as autoritetet vendore nuk kanë kryer hetime efektive lidhur me lëndët.

#### *Pajtueshmëria me rregullën e afatit 6 mujor*

91. Në bazë të rregullës 25, paragrafi 3, i Rregullores së Punës së Panelit, parashtruesi i ankesës është i detyruar të paraqes ankesën brenda gjashtë muajve nga vepra, vendimi apo sjellja, e cila thuhet se përbën ose përfshin ndonjë shkelje të të drejtave të tij/saj (shih, p.sh. *Gashi kundër EULEX-it*, nr. 2013-22, 7 prill 2014, § 10; *Thaqi kundër EULEX-it*, cituar më lartë, § 51).
92. Siç u përmend më lartë, ShM ka pohuar se ankuesit nuk kanë arritur të përmbushin këtë kërkesë procedurale.
93. Parashtrimet e ShM-së në këtë pikë duken se janë të bazuara në një keqkuptim rreth asaj se me çfarë ka të bëjë ankesa. Përderisa të afërmit e ankuesve me gjasë ishin vrarë në vitin 1999, shkelja e supozuar e të drejtave që lidhet me këto ankesa nuk ka të bëjë me ato ngjarje, por ka të bëjë me dështimin e supozuar të mëvonshëm dhe të vazhdueshëm nga ana e autoriteteve për të hetuar në mënyrë të duhur rrethanat e atyre vdekjeve.
94. ShM gjithashtu i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila ai thotë se mbështet pozicionin e tij. Në

veçanti, ShM i referohet lëndës *Varnava dhe të Tjerët kundër Turqisë* [GC], ku gjykata ka specifikuar se “*aty ku ka ndodhur vdekja, të afërmit e aplikantit priten të ndërmarrin hapa për të përcjellë progresin e hetimit ose mungesën e tij dhe për të parashtruar kërkesat e tyre pa vonesë, menjëherë pasi ata janë ose duhet të ishin të njoftuar për mungesën e ndonjë hetimi efektiv penal (...). Të njëjtat parime janë zbatuar mutatis mutandis (me ndryshimet e nevojshme) edhe në lëndët lidhur me personat e zhdukur (...)*”.

95. Paneli thekson se nga ankuesit në parim pritet që të kërkojnë mjetet ligjore në dispozicion të tyre në mënyrë energjike dhe të paraqesin ankesën e tyre pa vonesë (shih, p.sh. *Bulut dhe Yavuz kundër Turqisë* (vendim), nr. 73065/01, 28 maj 2002 dhe, *a contrario*, *Eren dhe të Tjerët kundër Turqisë* (vendim), nr. 42428/98, 4 korrik 2002, dhe *Üçak dhe Kargili dhe të Tjerët kundër Turqisë* (vendim), nr. 75527/01 dhe 11837/02, 28 mars 2006).
96. Në rastin konkret, ankuesit nuk duket se kanë ndërmarrë hapa serioz deri në vitin 2013 për t'i realizuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion të tyre. Asnjë shpjegim nuk është dhënë për të arsyetuar këtë pasivitet.
97. Megjithatë, tre faktorë kanë çuar Panelin që të konsideron këtë çështje më tutje: së pari, të drejtat e përfshira në këtë rast janë ndër të drejtat më të rëndësishme themelore të garantuara nga ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Disa prej tyre janë absolute dhe nuk kanë ndonjë përjashtim (neni 15 (2) të Konventës; shih gjithashtu *McCann dhe të Tjerët kundër aktgjykimit të Mbretërisë së Bashkuar* të datës 27 shtator 1995, Seria A nr. 324, §147; aktgjykimi *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar* i datës 18 janar 1978, Seria A nr. 25, § 163. Së dyti, kompetenca e prokurorëve të EULEX-it për të hetuar shkeljet e pohuara të këtyre të drejtave është e pavarur prej ndonjë ankese të paraqitur prej viktimave apo prej të afërmeve të tyre, pra ka pasur një pritje ligjrisht të bazuar se ata do ta shqyrtonin këtë rast, pavarësisht prej veprimeve të ankuesve, që në fakt e kanë bërë. Së treti, hetimi i plotë dhe i efektshëm i kësaj kategorie të rasteve është thelbësor për ndërtimin e një ndjenje të përgjegjësisë dhe kujdesit për sundimin e ligjit në çdo shoqëri pas konfliktit. Përgjegjësia për t'u marrë me këto raste i takon shoqërisë si një tërësi dhe jo vetëm atyre që janë prekur drejtpërdrejtë me të.
98. Përveç kësaj, ankesat nr. 2014-11 dhe 214-13 ishin parashtruar në Panel më 11 mars të vitit 2014. Ankuesit kanë marrë komunikimet e tyre të fundit nga PSRK-ja më 9 tetor dhe përkatësisht 20 shtator 2013. Sipas pikëpamjes së Panelit, këto mund që me të drejtë të konsiderohen si pika prej së cilës fillon afati 6 mujor, pasi është datë prej së cilës ankuesit mund të kenë kuptuar se asnjë hetim efektiv nuk do të kryhej lidhur me vdekjen e të afërmeve të tyre.
99. Për arsytet e cekura më lartë, ankesa mund të thuhet se është parashtruar me kohë.

100. Bazuar në atë që u tha më lartë, Paneli është i bindur se të gjitha kërkesat juridiksionale relevante janë plotësuar që kjo lëndë të shpallet e pranueshme.

## **PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI**

**SHPLL TË PRANUESHME**, pa paragjykuar meritat e çështjes, ankesat në lidhje me shkeljet e pohuara të neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe

**KËRKON SQARIME VIJUESE** nga palët dhe i fton të bëjnë parashtime shtesë në lidhje me to në qoftë se dëshirojnë:

1. A do të kenë kompetencë prokurorët e EULEX-it për të hetuar dhe, siç mund të ndodh, për të ndjekur penalisht këtë çështje në përputhje me “rrethanat e jashtëzakonshme” të nenit 7(A) të Ligjit të ndryshuar mbi Kompetencat dhe nëse po cilët faktorë duhet të jetë relevant në vendimin e tyre nëse do të veprohet në një rast të veçantë?
2. A ka marrë Misioni hapa për të shqyrtuar lëndët e bartura nga UNMIK-u, të cilat ishin “joaktive” dhe nëse po cilat janë ato hapa? A kanë pasur ndonjë mjet prokurorët e EULEX-it për t’ju qasur të dhënave apo dosjeve të lëndëve, të cilat janë cilësuar nga UNMIK-u si “joaktive”?
3. A janë shkelur nga EULEX-i ndonjë prej të drejtave të ankueses sipas nenit 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës?

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese